



## PROCESVERBAL XII/2021

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 13 (trembëdhjetë) për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 24.12.2021  
Ora: 10.00

---

### Prezentë në takim:

**Z. Shefket Kolgeci**

**Z.Selman Kolgeci**

**Z. Flamur Bytyqi**

**Z. Urim Suka**

**Z. Kushtrim Kuçi**

**Znj. Elmaze Bytyqi**

**Znj. Bulëza Kuçi**

**Znj.Doruntina Zenelaj**

**Z.Alban Berisha**

**Z. Bexhet Kuçi**

**Z. Reshat Selimaj**

**Z. Lirim Qatani**

**Z. Aziz Bytyqi**

**Znj.Sanie Kuçi-**

**Rexhepaj**

**Znj.Besa Kuçi**

**Znj.Fidaije Kukaj**

**Znj. Afërdita Morina**

**Z. Enver Shabani**

**Z. Driton Maliqaj**

**Z. Xhevshet Gashi**

**Z.Edon Sadikaj**

**Z.Dardan Berisha**

**Z.Bajram Basha**

**Znj.Mevlude Kabashi**

**Znj.Sheqerije Zyrapi**

**Znj.Laureta Tafaj**

**Z.Liridon Fandaj**

**Z.Qëndrim Elshani**

**Znj.Festë Kabashi**

**Z.Herolind Limaj**

**Znj. Jehona Rrafshi**

**Të pranishëm të tjerë**

**Kryetari Komunës**

**Media dhe qytetarë**

**OSCE, LMT, KDI**

**Znj.Habibe Bytyqi**

**Z.X heladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi .

### **REND DITE**

#### **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

#### **2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2022;**

**Kryesuesi** - përshëndet të pranishmit,i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

**28 për, 3 kundër  
Miratohet**

**Laureta Tafaj** - përshëndet të pranishmit.Mbledhja e KPF-së, a ka qenë e ligjshme dhe a jemi tu e mbajtur këtë seancë në mënyrë të ligjshme? Kërkoj sqarim nga zyrëtari ligjor

**Avni Bytyqi** - si zyrëtar ligjor jep sqarime shtesë.

**Laureta Tafaj** - anëtari jonë me të drejtë e ka lëshu mbledhjen atë ditë,dhe ne posedojmë sot që do ta lëshojmë mbledhjen.

**Avni Bytyqi** - ligjdhënësi i ka dhënë të drejtën çdo anëari të asamblesë të votojë për, kundër ose të apstenojë,të rri ose ta lëshojë mbledhjen.Kjo është e drejtë e juaja si veproni.

**Laureta Tafaj** - LVV lëshon mbledhjen,kurse përfaqësuesi i listës Guxo mbetet.

#### **Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - pyet nëse ka dikush vërejtje në procesverbal.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - përshëndet të pranishmit.Vërejtaja ime është që të përmirësohet emri dhe mbiemri në procesverbal.

**Kryesuesi** - e hedh në votim.

**Miratohet**

#### **Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave e të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2022;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Mevlude Kabashi** - përshëndet të pranishmit.Kam kërkesë nga fshati Mohlan.Ata kërkojnë që projekti që është për shtruarjen e disa rrugëve ,të kryhet gjatë periudhës 2021-2024. Gjithsej janë 12 rrugë,jo më të gjata se 30 m.RRuga „Azem Kabashi” , „Fazli Kabashi” , „Hajrullah Kabashi”, „Artan Kabashi” etj. Dhe hapja e disa rrugëve fushore. Kërkesa tjetër është për vitet në vazhdim, ndërtimi i një salle sportive në oborrin e shkollës „Naum Veqilhargji”.

**Urim Suka** - përshëndet të pranishmit.Sot është mire që të gjithë bashkë ti përmbushim obligimet tona dhe të punojmë për qytetarët pa dallim.Ne si LDK do të angazhohemi fuqishëm për një opozitë konstruktive dhe në mbrojtje të interesave të qytetarëve pa dallim.

Grupi i kuvendarëve të LDK-së rreth propozimit për miratimin e buxhetit konstaton se: Ky buxhet nuk është hartuar sipas kërkesave të qytetarëve dhe nuk i adreson problemet jetike të tyre; Ky buxhet nuk i adreson as qështjet që ju i keni premtu gjatë fushatës dhe nuk është profesional. Ky buxhet nuk duhet të hudhet në votim sot ,por duhet të kthehet,të përgatitet duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve,pa dallim.

Rrugët që i keni shtrur i keni fut prap për miratim për vitin 2022.Psh. në Peqan rruga „Emërllah Hoxha” dh rruga „ Kolonja” ;Sallagrazhdë rruga „Zef Tunaj” , „Mehmet Alia” dhe „9 Maji”etj.;Bllacë rruga,„ Fjolla”; rruga Kastërrc-Breshanc është e kryer.Duhla, „Budakova,Bllaca kanë nevojë për ujë dhe ju për tre vitet e ardhshme nuk keni parapa asnjë euro për ujë.Ka probleme me trotuarin e Bllacës,pastaj është problem i varrezave.Dukuri shqetësuese është që rrugët i ndani në dy tre pjesë.Psh.rruga rruga „Valbona” dhe „Kumanova” janë rrugë që i ke bo dy kontrata dhe nuk janë përfunduar,por ke vazhdu me shtrur rrugë tjera. Shqetësuese është edhe shëndetësia. Ky buxhet është mire që për shëndetësinë,për barnat të dyfishohet. Në Bllacë AMF-ja është jashtë funksionit. Na vie mire që keni nda buxhet në Grejkoc për sallën e sportit dhe shkollën teknike dhe gjithëashtu na vie mire që është nda buxhet për shkollën fillore „7 Marsi”.Është mire që të keni investime në shkollën „Dituria” në Samadraxhë. Pate premtu pagesën e udhëtimit për mësimdhënës,dhe sot shumica e shkollave që kanë ngrit padi për kontratën kolektive do ti tërhekin këto mjete.Është mire që në buxhetin e Komunës të parashihet kjo dhe të rregullohet e drejta e tyre dhe të realizohet. Ka katër vjet dhe shtëpia e kultures është jashtë çdo funksioni.Katër vjet qeverisje dhe asgjë ske bo për stadiumin e qytetit,dhe e ke pru ni vendim për miratim dhe prap ske parapa asgjë. Konstatoj që në emër të grupit të LDK-së ky buxhet nuk adreson shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve.Duhet të kthehet dhe të përmirësohet në bazë të interesave të qytetarëve e më pas të miratohet. Ne jemi kundër këtij buxheti.

**Aziz Bytyqi** - përshëndet të pranishmit.Në këtë buxhet ka kontribuar edhe përbërja e kaluar e Kuvendit.Kemi pas shumë takime në nivel të shefave të grupeve parlamentare dhe në nivel të debateve publike me qytetarë.Ky buxhet nuk ka kaluar për shkak se ishte një vit elektorale.Është koha ta mbështesim dhe në emër të grupit ju ofrojmë mbështetje totale.

**Selman Kolgeci** - përshëndet të pranishmit.Ky buxhet nuk i përmbush kërkesat e qytetarëve sa i përket investimeve kapitale.Ky buxhet përmban projekte të cilat janë realizuar para më shumë se pesë vitetve.Psh.në Bukosh rruga „Mentor Krasniqi” , „Baki Islami” , „Naser Baraliu”; në Peqan rruga „Kolonja” dhe „Emërllah Hoxha”;në Sallagrazhdë rruga „Mehmet Alija” , „Zef Tunaj” , „Avdyl Ramadani”.Ka raste edhe në shumë fshatra,si në Maqitevë,Kastërrc,Budakovë etj.Rastet tjera janë edhe në fshatrat:Maqitevë,Kastërrc,Budakovë,Samadraxhë etj.Ndërsa në fshatin Vraniq është parapa ndërtimi i rrugës „Te Antena”, „Te Quka” dhe seg. i rrugës „Ali Loshi”,edhe ky projekt ka qenë i kontraktuar vitin e kaluar.Nuk është planifikuar asnjë euro në ujësjellës dhe në varrezat e reja,e që janë prioritet. Nuk janë nda mjete për mbykqyrjen dhe hartimin e projekteve Si po mendoni tërë këto investime kapitale ti realizoni pa asnjë projekt?Z. Muharremaj,a keni vedndos me metodën e tahminit ti realizoni projektet kapitale apo përpiluesit e këtij draft-buxheti nuk kanë njohuri elementare. Nga ato që thash më lart,më bën të kuptoj që ky buxhet po lan hesapet elektorale të fushatës së fundit.Nëse ky buxhet aprovohet si i tillë,është vetëm për organet e drejtësisë dhe hetuesisë.

**Dardan Berisha** - përshëndet të pranishmit.Buxheti i vitit të fundit të qeverisjes është bo standart mos me kalu. Ne sot jemi pro këtij vendimi.

**Festë Kabashi** - përshëndet të pranishmit.Për buxhetin e vitit 2022 kam nevojë për sqarime shtesë për disa nga pikat.Kam vërejtur që disa nga pikat e përfshira të vitit 2021 janë projekte të cilat figurojnë edhe në vitin 2022 dhe ka të tilla që janë bartur edhe nga viti 2020.Raste të tilla

kemi në Baqevc,Dubravë ,Peqan,Qadrak,Kastërrc,Krushicë e Poshtme etj.Nuk e kam të qartë,a janë gabime në shkrim apo në realizim.Psh.Ndërtimi i rugëve në lagjen e Gashve i cili figuron në vitn 2020-2021-2022 dhe ndërtimi te lagjja e Lumit dhe lagjja e Re janë projekte të bartura nga viti 2021.Çfarë ka ndodhur me këto projekte? Pse ende nuk është ndërtuar fusha sportive në Krushicë të Poshtme dhe është bartur nga buxheti i vitit paraprak. Ndërtimi i aneksit të palestrës sportive „13 Qershori”në Suharekë,dua të di në cilën pjesë është parapa të ndërtohet ,pse do të shfrytëzohet dhe në çka është parapa të invstohet kjo shumë prej 70.000 eurosh? Si përfaqësuese e Listës Guxo e mbështes këtë buxhet.Shumë ndërtesa të vjetra banesore janë renovuar,dhe propozoj që edhe ndërtesa e Solidaritetit përballë banesave të Ballkanit të renovohet(të bëhet fasadimi dhe renovimi i hyrjeve të përbashkëta).

**Doruntina Zenelaj** - përshëndet të pranishmit.Konsideroj që vendimet tona të jenë në interes të qytetarëve pavarësisht se a jemi pjesë e opozitës apo pozitës .Unë nuk do të votoj pro këtij projekt- buxheti derisa të mos merren parasysh propozimet tona,sepse mendoj që ky buxhet nuk i përmbush kërkesat e qytetarëve. Në Savrovë është parapa shtrimi i rrugëve Djemtë e Lirisë dhe Hamzi Bytyqi të cilat nuk ekzistojnë fare.Për ndriçimin në Savrovë nuk është cekur për cilën rrugë është fajala,edhe kanalizimi është parapa por nuk është cekur në cilat lagje. Në Maqitevë është parapa meremetimi i shkollës,por shkolla është renovuar gjatë këtij viti. Në shumë vende është shkruar e tjera,e tjera,por kjo len hapsirë, që një hapsirë e buxhetit të alokohet nëpër projekte selektive të cilat nuk janë parapa.

**Flamur Bytyqi** - përshëndet të pranishmit.Është planifikuar 55.000 euro renovimi i Komunës në vitin 2022 dhe në vitin 2023 keni planifikuar ndërtimin e objektit të Komunës së re.A është kaq emërgjent ky renovim,apo planifikimin për ndërtimin e Komunës së re keni dyshim se nuk mund ta realizoni? Te planifikimi i investimeve në infrastrukturën rrugore bujqësi-pylltari keni planifiku të investoni 140.000 euro për vitin 2022 pa i specifiku se ku do të shkojnë këto mjete. Te bujqit nuk keni parapa asnjë investim për mbrojtje nga vërshimet. Në fshatin Samadraxhë keni planifikuar ndërtimin e rrugës Jusuf Gërvalla ,por kjo rrugë është ndërtuar para dy mandateve.Nuk keni planifiku buxhet për funksionalizimin e ujës-jellësit për fshatin Peqan.A keni mjete të ndara për stadiumin e qytetit kur e dim në çfarë gjendje është, sa mjete do ti ndani për dhe a do të përfundojë gjatë mandatit të dytë?A ka dorëzuar Komuna kërkesë në MKRS për investimet në stadium? Kërkoj që ta ndihmoni klubin e shigjetarisë “Luzhnica”,i cili ushtrimet i zhvillon në kulm të banesave.Mendoj që ky buxhet nuk duhet të futet në votim.

**Kushtrim Kuçi** - përshëndet të pranishmit.Vërejtja ime e pare është që të vendosen rrethojat te tranziti. Duhet të investohet te banesat në qendër të Suharekës.Duhet të vendosni rrethoja përrreth pemëve që janë mbjell në shesh në mënyrë që të mbrohen.Vërejtja tjetër është te parqet.Ulëset në të gjitha parqet janë të llojit të njejtë,dhe ka dhe lloje tjera që janë më atraktive.Parqet shumë mire që janë bo,mirëpo brenda dy muajve shkatërrohen dhe është mire që të bëhet një park më pak dhe me ato para të mbikqyren parqet.Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skëndërbeu Suharekë,a përfshihet edhe rruga Hajdin Berisha? A ka status rreth themelimit të bibliotekës “Hajdin Berisha”? Janë nda 60.000 për ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës së brendshme të bibliotekës „Hajdin Berisha”dhe rregullimi i shtëpisë së kulturës Samadaxhë,specifikoni se si janë nda këto para?

**Driton Maliqaj** - përshëndet të pranishmit.Kryetari Muharremaj e ka marrë një shpërblim për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore në nivel vendi nga ambasada britanike.I ftoj gjithë asambleistët që të marrin pjesë në dëgjimet buxhetore dhe ti shihni kërkesat e qytetarëve,të cilat kërkesa janë kryesisht për rrugë dhe për ambient e që janë të pasqyruara në këtë buxhet.Në mandatin e kaluar

është bërë aq shumë në rrugë ,saqë mbesin disa rrugë ,e duhet të përsëriten me emra të njejtë.Po harroni të citoni ku thuhet se është segment i rrugës.Ju lus të reflektoni dhe ta votoni.

**Urim Suka** - mendoj që nuk kemi nevojë për leksione,kemi thënë më pak se sa duhet.I thamë me raste konkrete, dhe kemi qenë edhe ne në takime.Budakova,Duhla,Bllaca po kërkon ujë dhe s'ke parapa.Ta keni parasysh që pozita e ka përgjegjësi me përgatit një buxhet më të mire.Ne këto vërejtje nuk po i bëjmë vetëm për me bo opozitë.E tha edhe Selmani se ku pëfundon ky buxhet nëse e mbështesim.Ju kisha lut që ta bëjmë një buxhet që është në interes të qytetarëve.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth themelimit të bibliotekës.

**Shefket Kolgeci** - përshëndet të pranishmit.Fillimi i ndërtimit të një buxheti janë kryesitë e fshatrave.Asnjë mbledhje me kryesitë e fshatrave nuk e ke bo dhe nuk ke asnjë kryesi të fshatrave funksionale.Thjeshë,është i kryesive të AAK-së.Grupi parlamentar nuk do ta votoj këtë buxhet për arsye se nuk është në harmoni me interesat e qytetarëve.

**Kryesuesi** - e hedh në votim.

### **19 për dhe 9 kundër Miratohet buxheti**

**Kryetari** - përshëndet të pranishmit.Falemnderon legjislaturën e kaluar dhe të tashmen dhe iu uron festat.

**Alban Berisha** - përshëndet të pranishmit.Kryetar pat shumë vërejtje, dhe të pakten të thojë një fjalë.A jeni pajtuar apo çka?

**Kryetari** - jep përgjigje.

Takimi përfundoi: **11:05**

**Procesmbajtësja**  
Dafina Haziraj